RELACION

P R O J E K T V E N D I M

PËR

PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS NË PARA TË NJË VOTE TË VLEFSHME PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja "n" dhe pika 2, nenit 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 21 datë 13.07.2021 të Komisionit Rregullator "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021", pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin të përcaktojë me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme.

Referuar nenit 88 pika 2, KQZ-ja, brenda 10 ditëve nga nxjerrja e rezultatit perfundimtar në shkallë vendi përcakton me vendim vlerën në para të një vote te vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar , me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.

Komisioni Rregullator miratoi me Vendimin nr.21 datë 13.07.2021, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Në lidhjen nr.1 bashkëlidhur vendimit, përcaktohen votat e vlefshme dhe përqindja për cdo subjekt pjesëmarrës në zgjedhje ku rezulton se , partitë që kanë përfituar jo më pak se 1 % të votave dhe votat e vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë si më poshtë:

1.	Partia Socialdemokrate (PSD)	35,475 vota	2,2479%
2.	Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	107.538 vota	6,8143%
3.	Partia Demokratike "Aleanca për ndryshim" (PD-AN)	622.187 vota	39,4259%
4.	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	768.134 vota	48,6741%
	Gjithsej vota të vlefshme	**1 533 334 vota**	

Rruga Ibrahim Rugova Nr. 4
Tiranë 1007, Shqipëri
www.kqz.gov.al
info@kqz.gov.al

Në bazë te nenit 180 pikës 4 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, në zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji fondi nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje përcaktohet se do të jetë 2 herë më i madh , se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Fondi i vënë në dispozicion në vitin zgjedhor 2017 ishte 65,000,000 lekë, pra rrjedhimisht u caktua që për vitin zgjedhor 2021 fondi i përgjithshëm i miratuar të ishte 130,000,000 lekë.

Pjestimi i fondit të përgjithshëm të miratuar me numrin në total të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi sjell si rezultat vlerën në para të një vote të vlefshme 130,000,000 (njëqind e tridhjetë milion) lekë / 1,533,334 (një milion e pesëqind e tridhjetë e tre e treqind e tridhjetë e katër) vota = 84,78 (≈ 85) lekë.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Qëllimi i këtij projekvendimi është përcaktimi i vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shqyrton dhe miraton projektvendimin "Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021".

Valbona BALLGJINI - Drejtor, Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm
Madalena Koja - Drejtor, Drejtoria Juridike dhe Dokumentacionit Zgjedhor
Aurel Lamçe - Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse
Ylli Merkaj - Sekretar i Përgjithshëm

Rruga Ibrahim Rugova Nr. 4
Tiranë 1007, Shqipëri
www.kqz.gov.al
info@kqz.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: Korrik 2021 | Nr:

PROJEKTVENDIM

PËR

PËRCAKTIMIN E VLERËS NË PARA TË NJË VOTE TË VLEFSHME PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja "n" dhe pika 2, nenit 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 21 datë 13.07.2021 të Komisionit Rregullator "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021",

VEREJ:

Neni 88 pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjestuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.

Referuar lidhjes nr. 1, të Vendimit nr. 21 datë 13.07.2021 "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021", partitë që kanë përfituar jo më pak se 1 për qind të votave dhe votat e vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë si më poshtë:

1.	Partia Socialdemokrate (PSD)	35,475 vota	2,2479%
2.	Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	107.538 vota	6,8143%
3.	Partia Demokratike "Aleanca për ndryshim" (PD-AN)	622.187 vota	39,4259%
4.	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	768.134 vota	48,6741%
	Gjithsej vota të vlefshme	**1 533 334 vota**	

Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, referuar pikës 4, të nenit 180 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhet e para pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit, parashikohej të ishte 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Fondi i vënë në dispozicion në vitin zgjedhor 2017 ishte 65,000,000 lekë, pra rrjedhimisht u caktua që për vitin zgjedhor 2021 fondi i përgjithshëm i miratuar të ishte 130,000,000 lekë.

Referuar nenit 88 pika 2, të Kodit Zgjedhor, pjestimi i fondit të përgjithshëm të miratuar me numrin në total të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi sjell si rezultat vlerën në para të një vote të vlefshme 130,000,000 (njëqind e tridhjetë milion) lekë / 1,533,334 (një milion e pesëqind e tridhjetë e tre e treqind e tridhjetë e katër) vota = 84,78 (≈ 85) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "n" dhe pika 2, nenin 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 21 datë 13.07.2021 të Komisionit Rregullator "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021"

V E N D O S:

1. Vlera në para e një vote të vlefshme është 85 (tetëdhjetë e pesë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI